



Pa. nr. 08-60

Komisioni për Mbrojtjen e konkurrencës në bazë të nenin 28 dhe nenin 19 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10 dhe 136/11 dhe 41/14 dhe 53/16), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Ulisse Investissment S.A., me seli në adresën Nivo 5, Ndërtesa bn Bankë për zhvillim të Samoa, Biç Roud, Apia, Samoa nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Knezoviç dhe bashkëpunorëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur me datë 04.01.2017, miratoi

#### AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi me të cilin Ulisse Investissment S.A., me seli në adresën Nivo 5, Ndërtesa bn Bankë për zhvillim të Samoa, Biç Roud, Apia, Samoa do të fitoj kontrollin mbi shoqërinë Mojoman Propertis Ltd., me seli në adresën Trident Çembers kutia postare 146, Road Taun, Tortola, Ishujt e Virgjër Britanikë, nëpërmjet blerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrimin të paguaj taksë administrative të njoftimit për përqendrim në shumë prej 6 000,00 den. dhe për vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit të tarifës 28-a të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

#### Arsyetim

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11, 41/14 dhe 53/16 në datë 21.12.2016, plotësuar më 09.01.2017, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) merr njoftimin për përqendrim me të cilin Ulisse Investissment S.A., me seli në adresën Nivo 5, Ndërtesa bn Bankë për zhvillim të Samoa, Biç Roud, Apia, Samoa



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



do të fitoj kontrollin mbi shoqërinë Mojoman Propertis Ltd., me seli në adresën Trident Çembers kutia postare 146, Road Taun, Tortola, Ishujt e Virgjër Britanikë, nëpërmjet blerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit të përqendrimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të parashtruara në Njoftimin e përqendrimit dhe anekseve të tij konstatoi si më poshtë:

Ulisse Investissment S.A., është pjesë e Hoche Partners Group të shoqërivë ( „Hoche Partners Group”) e cila kryesisht merret me këshillim dhe investime në fushat e mëposhtme: patundshmëritë, energjinë, hotelieri, art dhe lëndët e para.

Mojoman Propertis Ltd. është një kompani holding dhe si e tillë nuka ka aktivitete të biznesit. Mojoman indirekt përmes kompanive të saj të lidhura ka aksione në kompaninë Direkt Media shpk Beograd, me seli në adresën Lufta anti-fashiste 13b, Beograd, Serbi ("Direct Media Beograd"), e cila është në krye të Direkt Media Group të shoqërive ( "Direct Media Group" ). Direct Media Group ofron një gamë të gjerë shërbimesh në tregun e reklamave në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë edhe Maqedoninë.

Në Maqedoni Direkt Media Group, është e pranishme nëpërmjet një shoqërie: Direct Media shpknjp Shkup, agjencia për marketing, me seli në Crvena Voda nr. 7, Shkup

Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi ajo i plotëson kërkesat e nenit 12 (1), pika 2) dhe neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pika 6 (b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës miraton aktvendim në formë të shkurtuar, Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, është në përputhje me të sepse nuk do ketë si pasojë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive në treg ose në pjesën themelore të saj, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh vlerësimin e këtillë të përqendrimit, Komisioni vendosi ashtu siç parasheh dispozitivi i këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



Mjeti juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për nisje të kontestit administrativ në Gjyqin administrativ në Republikën e Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR  
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS  
BLLAGOJ ÇURLINOV